



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 25.02.2025

Nr: 8

Ora: 11:45

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 03, DATË 21.02.2025
TË DEPOZITUAR NGA QENDRA “QËNDRESA QYTETARE”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 25.02.2025, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Qendra “Qëndresa Qytetare”

OBJEKT: Shfuqizimi i vendimit nr. 129, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Vendosja e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës për raportimin në Kryeministri; Vendosja e sanksionit administrativ ndaj Kryeministrit.

BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja “b”, 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Qendra “Qëndresa Qytetare”, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 03 regj., datë 21.02.2025.

Në mbledhjen e datës 24.02.2025, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 03, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

KAS, vendosi pranimin e pjesërisht për shqyrtim administrative të kërkesës ankimore nr.3 dhe kalimin për shqyrtim vetëm për pikën 1 të objektit të ankimit të kërkuar nga ankuesi, që ka të bëjë me shfuqizimin e vendimit nr.129, datë 20.02.2025 të KSHZ.

Për sa i përket pikave 2 dhe 3 që kanë të bëjnë me vendosje sanksion administrative, KAS nuk ka kompetencë për ti shqyrtuar këto kërkesa, si organ që vendos në lidhje me sanksionet vetëm në varësi të propozimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 03, datë 21.02.2025, të paraqitur nga Qendra “Qëndresa Qytetare”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 27.02.2024, ora 15:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar